



INFORMATA BAZIKE:

Lajmëruesit e Dezinformatave – Monitorimi i Mediave Ruse është një raport mujor i lajmeve që përmbajnë dezinformata dhe keqinformime që e vëjnë në shënjestër Kosovën, dhe që janë të botuara në mediat ruse në gjuhën angleze dhe serbe.

PËRKRAHUR NGA:



Londër, Mbetëria e Bashkuar

VËREJTJE:

Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë vetëm të Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED).

KONTAKTI:

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)
Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1
10 000 Prishtina, Kosovo
Tel: +383 (0)38 542 778
Web-site: www.kipred.org
Email: info@kipred.org

LAJMËRUESIT E DEZINFORMATAVE PËR KOSOVËN

MEDIAT RUSE

QERSHOR 2020

HYRJE

Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën: Mbikëqyrja e Mediave Ruse, synon t'i kundërvihet dezinformatave që e vejnë në shënjestër Kosovën, përmes mbikëqyrjes në bazë mujore të botimeve mediale të përzgjedhura, si në gjuhën angleze, ashtu edhe në atë serbe, që origjinën e kënë në Rusi. Mediat e përzgjedhura në gjuhën angleze janë Russia Today, Sputnik, Meduza, Russia Insider, TASS, The Moscow Times, Newsfront, Unz, Duran, dhe Pravda Report, ndërsa në gjuhën serbe është Sputnik Serbia. Pos kësaj, Lajmëruesit e Dezinformatave për Kosovën i mbikëqyrin edhe lajmet, dokumentet dhe deklaratat që kanë të bëjnë me Kosovën, të botuara nga Kremli dhe nga Ministria Ruse e Punëve të Jashtme.

Gjatë qershorit 2020, TASS-i i ka botuar 11 lajme, Russia Today 14, The Duran 3, Sputnik International 3, Newsfront 9, dhe Unz-i 1, dhe Sputnik Serbia i ka botuar edhe 157 lajme të tjera që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë patur të bëjnë me Kosovën. Ndërkohë, The Moscow Times, Russia Insider, Meduza dhe Pravda Report nuk kanë botuar asnjë lajm të ndërlidhur me Kosovën. Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe monitoruese, Kremli nuk e kishte asnjë, ndërsa Ministria e Jashtme Ruse i kishte 9 postime që kishin të bënin me Kosovën në ueb-sajtet e tyre.

Për shkak të numrit të madh të artikujve me përmbajtje dezinformuese të prodhuara nga këto media, në këtë botim janë analizuar vetëm artikujt me përmbajtjet dezinformuese më flagrante. Dezinformatat e bëra synojnë t'ua shkatërrojnë themelet legalitetit të shtetësisë së Kosovës dhe përpjekjeve të NATO-s dhe të Perëndimit për paqe dhe stabilitet në Kosovë dhe për avancimin e procesit të saj shtet-ndërtues, përmes pasqyrimin të Kosovës si një shtet i dështuar që ndërmerr veprime diskriminuese kundër komunitetit të vet serb, pastaj, që ta mjeçullojnë të kaluarën, duke i mohuar faktikisht krimet dhe mizoritë e Serbisë në Kosovë gjatë viteve 1990, dhe t'ia shkatërrojë themelet rolit të SHBA-ve dhe të BE-së në themelimin e Dhomat të Specializuara të Kosovës.

DEKONSTRUKTIMI I DEZINFORMATAVE

Lajmërim i Dezinformatës 1

Titulli: The Kosovo knot: Is a fair solution possible? [Nyja e Kosovës: A është e mundshme zgjidhja e drejtë?], Artikull i shkruar bashkarisht nga Ministri i Jashtëm Rus, Sergey Lavrov, dhe Zëvendës-Kryeministri i Parë dhe Ministri i Jashtëm i Republikës së Serbisë, Ivica Dačić, i botuar në **Rossiyskaya Gazeta** dhe **Kurir-in** e Serbisë, më 18 qershor 2020, i postuar në ueb-sajtin e **Ministrisë Ruse të Punëve të Jashtme**,¹ dhe i komentuar nga **TASS-i**.²

Ndër të tjera, në artikullin e tyre të përbashkët, Ministrat e Jashtëm Lavrov dhe Dačić pohojnë në mënyrë të gabuar që: “Problemi i pazgjidhur i Kosovës për më tepër se 20 vite ka qenë pengesë për një stabilizim të plotë të rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe ka shkaktuar më shumë shpërthime të tendosjeve. Bomba me sahat u përgatit në kohën kur aleatët perëndimorë që e bombarduan Jugosllavinë në vitin 1999 e përcaktuan qëllimin që ta sigurojnë pavarësinë e rajonit duke e anashkaluar të drejtën ndërkombëtare”; “Në vitin 2008, kur “pavarësia” u shpall në Prishtinë përmes një akti të kryer, u bënë përpjekje këmbëngulëse për të bindur Moskën e Beogradin që të bësojnë që mundësitë negociuese janë shterrur. Thirrjet e Ruisë dhe Serbisë, përfshirë edhe në nivelin më të lartë, për t’i vazhduar bisedimet dhe për t’iu përmbajtur të Drejtës Ndërkombëtare dhe Rezolutës 1244 të KS KB, u injoruan. Disa vite më vonë, zhvillimet bënë që palët ta vazhdojnë dialogun. Brukseli veproi si ndërmjetës, dhe Asambleja e Përgjithshme e KB këtë e miratoi me Rezolutën 64/298 në vitin 2010”; “Kosova është e mbërthyer nga kaosi politik. Partitë lokale janë të zhytura në një luftë të hidhur për pushtet, duke bërë akuza të ndërsjella dhe duke shkaktuar grindje të klaneve në mes të rënies ekonomike dhe krimit të shfrenuar. Në këto rrethana, “shtet-ndërtimi,” për të cilin udhëheqësit lokalë dhe sponsorët e tyre të jashtëm kanë dëshirë të flasin, është kthyer në një mashtrim”; “Prania e gjerë në Kosovë e elementeve kriminale të shoqëruara me grupet terroriste në Lindjen e Mesme, dhe para së gjithash në Siri, si dhe me bandat kriminale në Ballkan e në pjesë të tjera të Evropës, don të thotë që rajoni, me

¹ https://www.mid.ru/en/web/guest/maps/us/-/asset_publisher/unVXBbj4Z6e8/content/id/4168272

² <https://tass.com/politics/1168953>

trashëgiminë e vet të pasur historike dhe kulturore, është duke u shndërruar në një strofull të banditëve dhe kriminelëve të të gjitha llojeve”; “A duhet që kjo të na befasojë kur kryebanditët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë futur në strofull si elitë udhëheqëse e Prishtinës? Për t’i hetuar mizoritë, përfshirë vrasjet dhe rrëmbimet me qëllim të trafikimit të jashtëligjshëm të organeve njerëzore që është bërë nga disa prej tyre, është krijuar një gjykatë speciale me nismën e BE-së, pas raportit të anëtarit të PACE, Dick Marty. Ende jemi duke pritur që ky trup juridik të ngjallet dhe t’i bëjë akuzat kundër kriminelëve”; dhe, “Para fazës së re në dialog, ishte e domosdoshme të tërhiqeshin masat diskriminuese anti-serbe të vendosura nga autoritetet e Prishtinës në vitet e fundit. Si ndërmjetës, BE-ja duhet të sigurojë që kosovarët të mos e vazhdojnë këtë praktikë të mbrapshtë.”

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Për ironi, njëri nga bashkautorët e këtij artikulli, Ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Dačić, ka qenë Zëdhënës i Milosheviqit gjatë Luftës së Kosovës në vitin 1999, dhe tjetri, Ministri i Jashtëm Rus, Sergey Lavrov, në të njëjtën kohë ishte Përfaqësues i Rusisë në Kombet e Bashkuara.

Fillimisht, autorët pohojnë gabimisht që bombardimi i NATO-s “e ka përcaktuar si qëllim sigurimin e pavarësisë së rajonit, duke e anashkaluar të Drejtën Ndërkombëtare,” duke e injoruar kështu faktin thelbësor që fushata e bombardimeve ishte pasojë e mizorive të Millosheviqit kundër shqiptarëve të Kosovës, dhe e refuzimit të tij për ta nënshkruar Marrëveshjen e Rambujesë, të ndërmjetësuar nga Ambasadori i SHBA-ve, Christopher Hill, i Dërguari i BE-së, Ambasadori Wolfgang Petritsch, dhe Ambasadori Rus, Boris Mayorski. Është e rëndësishme që këtu të theksohet që para intervenimit të NATO-s, forcat jugosllave tashmë i kishin vrarë mbi 2,000, i kishin burgosur mbi 1,200, dhe i kishin zhvendosur rreth 300,000 shqiptarë të Kosovës.³ Të gjitha këto fakte bëhen edhe më të qarta dhe më evidente në deklarin e 24 marsit, 1999, të Presidentit amerikan Clinton, në të cilin ai theksonte që “Ne dhe aleatët tanë të NATO-s e kemi ndërmarrë këtë veprim pas përpjekjeve gjithëpërfshirëse dhe të përsëritura për ta arritur një

³ Eric Herring, ‘From Rambouillet to the Kosovo accords: NATO’S war against Serbia and its aftermath’ [Nga marrëveshja e Rambujesë e deri te ajo e Kosovës: Lufta e NATO-s kundër Serbisë, dhe më pas], *The International Journal of Human Rights*, Routledge, tetor 2007.

zgjdhje paqësore të krizës në Kosovë,” dhe që goditjet ushtarake i kishin qëllimet në vijim: “të demonstrojnë vendosmërinë e NATO-s, ta frenojmë Beogradin nga nisja e ofensivave të reja kundër shqiptarëve të Kosovës, dhe t’i ulim aftësitë ushtarake të Jugosllavisë për të zhvilluar sulme të ardhshme.”⁴ Brenda disa javëve pas fillimit të intervenimit të NATO-s, forcat e armatosura serbe i kishin vrarë më shumë se 9,000, dhe i kishin dëbuar në Shqipëri dhe në Maqedoni rreth 860,000 shqiptarë të Kosovës.⁵ Qëllimi i NATO-s në mënyrë të qartë nuk ka patur se si të jetë pavarësia e Kosovës, në sajë të vetë faktit që Spanja dhe Greqia ishin anëtare të plota të Aleancës në vitin 1999, dhe ato Kosovën nuk e kanë njohur as deri më sot.

Autorët këtu janë duke e paraqitur Rezolutën 1244 (1999) të KS KB si një pengesë ndaj ligjshmërisë së pavarësisë së Kosovës, duke e injoruar në këtë mënyrë Opinionin Këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Pajtueshmërinë me të Drejtën Ndërkombëtare të Shpalljes së Njëanshme të Pavarësisë në Raport me Kosovën, të 22 korrikut 2010, i cili e kishte thënë qartë që Deklarata e Pavarësisë së Kosovës nuk e kishte shkelur të Drejtën Ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe Rezolutën e KS KB 1244 (1999).⁶ Për më tepër, ata janë po ashtu duke e shpërfillur faktin që Rezoluta 64/298 e Asamblesë së Përgjithshme të KB e shtatorit 2010, BE-në nuk e mandaton për ta ndihmuar dialogun midis Kosovës dhe Serbisë rreth çështjes së statusit të Kosovës – në vend të kësaj, ajo e përcakton që synimi i dialogut “do të jetë ta përparojë bashkëpunimin, të arrijë përparim në rrugën drejt Bashkimit Evropian, dhe t’i përmirësojë jetët e njerëzve.”⁷

Pos kësaj, autorët nuk ngurrojnë që Kosovën ta paraqesin si një shtet të dështuar, dhe përpjekjet ndërkombëtare për shtet-ndërtim si një “mashtim.” Ata madje edhe proceset demokratike në vend i përshkruajnë si “grindje të klaneve,” me “ekonominë në rënie” të shoqëruar me “krim të

⁴ Shih: CNN: NATO Attack on Yugoslavia begins [Sulmi i NATO-s mbi Jugosllavinë fillon], 24 mars 1999, <http://edition.cnn.com/WORLD/europe/9903/24/kosovo.strikes/>

⁵ Për një hetim më të thellë për pasojat e krizës së refugjatëve të Kosovës, shih, për shembull,: Jim Whiteman, The Kosovo Refugee Crisis: NATO’s humanitarianism versus human rights [Kriza e refugjatëve të Kosovës: Humanitarizmi i NATO-s përballë të drejtave njerëzore], *The International Journal of Human Rights*, Vol. 4, Issue 3-4, Taylor & Francis, 2000.

⁶ Opinioni Këshillues i GJND-së për Shpalljen e Njëanshme të Pavarësisë së Kosovës, 22 korrik 2010, <https://www.icj-cij.org/files/case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf>

⁷ Rezoluta 64/298 e UNGA, 13 tetor 2010, <https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/ROL%20A%20RES64%20298.pdf>

shfrenuar.” Sipas raportit të kohëve të fundit të Bankës Botërore, “Kosova në vitin 2020 ka qenë e projektuar të rritet rreth 4 përqind, mirëpo, për shkak të shpërthimit të pandemisë COVID-19, pritet që ekonomia të tkurret për 4.5 përqind, ndërkohë që eksportet e shërbimeve, si dhe investimet publike dhe private do të bijnë,” ndërkohë që “Për shkak të pandemisë COVID-19, në vitin 2020 ekonomia e Serbisë do të hyjë në recesion. ... Në skenarin më të butë, GDP-ja e Serbisë në vitin 2020 do të bjerë për 2.5 përqind.”⁸ Këto shifra, të publikuara nga Banka Botërore, e tregojnë një rrëfim të kundërt me atë që janë duke e pohuar Lavrovi dhe Dačići. Raportet e Këshillit Këshillues të Sigurisë së Jashtme të Departamentit të Shtetit të SHBA-ve për Kosovën dhe Serbinë, për vitin 2019, po ashtu e tregojnë të kundërtën e asaj që Lavrovi dhe Dačići janë duke u përpjekur të përhapin lidhur me krimin në Kosovë. Sipas këtyre raporteve, rreziku i krimit në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë, konsiderohet si i butë,⁹ ndërkohë që në kryeqytetin e Serbisë, ky rrezik merret se është i konsiderueshëm, dhe ata po ashtu thonë që “rreziku i konsiderueshëm nga krimi [në Serbi] është për shkak të veprimtarive të grupeve të Krimin të Organizuar (OC), meqë Serbia është rrugë kryesore trafikuese nga Lindja drejt Evropës.”¹⁰

Pos të gjitha këtyre, dy ministrat e jashtëm janë duke e shpërfillur faktin që Dhomat e Specializuara janë themeluar me vendimin e Kuvendit të Kosovës të 3 korrikut 2015,¹¹ dhe që me këtë veprim Kosova e ka dëshmuar përgjegjësinë që e ka ndaj drejtësisë për krimet e supozuara të luftës, gjë kjo që nuk do të mund të thuhet edhe për Serbinë. “Libri i Kujtesës së Kosovës” (2 shkurt 2015), i botuar nga Qendra e të Drejtës Humanitare me seli në Beograd, i konfirmon vdekjet dhe zhdukjet e 13,535 individëve gjatë luftës në Kosovë dhe menjëherë pas saj (1 janar 1998 – 31 dhjetor 2000). 10,812 nga këta individë ishin shqiptarë, 2,197 ishin serbë, ndërsa 526

⁸ World Bank Group, Western Balkans Regular Economic Report, The Economic and Social Impact of COVID-19 [Raporti i Rregullt Ekonomik për Ballkanin Perëndimor, Impakti Ekonomik dhe Social i COVID-19], Pranverë 2020, <http://documents1.worldbank.org/curated/en/457181588085856454/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-The-Country-Notes.pdf>

⁹ OSAC, Kosovo 2019 Crime & Safety Report [Raporti për Krimin e Sigurinë në Kosovë për vitin 2019], 23 nëntor 2019 [https://www.osac.gov/Country/Kosovo/Content/Detail/Report/d0ff62ac-1d7b-45dd-84a4-15f4aeb9e219w::~:~:text=There%20is%20moderate%20risk%20from,influences%20crime%20rates%20in%20Kosovo.&text=According%20to%20Kosovo%20Police%20\(KP,of%20grievous%20thefts%20was%205%2C222.](https://www.osac.gov/Country/Kosovo/Content/Detail/Report/d0ff62ac-1d7b-45dd-84a4-15f4aeb9e219w::~:~:text=There%20is%20moderate%20risk%20from,influences%20crime%20rates%20in%20Kosovo.&text=According%20to%20Kosovo%20Police%20(KP,of%20grievous%20thefts%20was%205%2C222.)

¹⁰ OSAC, Serbia 2019 Crime & Safety Report [Raporti për Krimin e Sigurinë në Serbi për vitin 2019], 3 nëntor 2019, <https://www.osac.gov/Country/Serbia/Content/Detail/Report/452bd4dc-9d15-491b-b271-15f4aeb34077>

¹¹ Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyren e Prokurorit të Specializuar, Gazeta Zyrtare e Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11036>

viktima ishin romë, boshnjakë, malazezë dhe jo-shqiptarë të tjerë.¹² Për më tepër, nga viti 1999 deri më 2018, institucionet e drejtësisë në Kosovë për krime të luftës, i kanë akuzuar 111 veta, 61 nga të cilët ishin shqiptarë, 44 serbë, 5 malazezë dhe 1 rom. Nga 61 shqiptarët e akuzuar, 34 u dënuan, 23 u liruan, 2 janë në arrati, dhe 2 janë ende në procedim juridik. Nga 44 serbët e akuzuar, 4 u dënuan, 13 u liruan dhe 23 janë në arrati.¹³ Nga ana tjetër, institucionet serbe të drejtësisë për krimet e kryera në Kosovë deri më tash i kanë dënuar 17 serbë, të cilët gjatë luftës ishin ushtarë të thjeshtë apo policë, por pothuaj asnjëri prej tyre nuk i takonte hierarkisë komanduese, ndërkohë që Tribunali Ndërkombëtar për Krimet e Luftës në Jugosllavi i ka dënuar gjashtë përfaqësues të lartë serbë.¹⁴

Ndërkohë që nuk ka ndonjë dëshmi për ndërlidhjen midis kriminelëve dhe luftëtarëve të huaj terroristë nga Kosova, është e vërtetë se që nga viti 2012 një numër i vlerësuar prej 255 luftëtarëve të huaj kanë shkuar nga Kosova për t'iu bashkangjitur organizatave terroriste në Siri dhe Irak. Nga ana tjetër, që nga viti 2014, Policia e Kosovës, si dhe institucionet e saj prokuroriale dhe juridike kanë vepruar, dhe në gusht 2014, janë arrestuar 40 qytetarë kosovarë të dyshuar se kanë marrë pjesë në terrorizmin në Irak dhe në Siri. Deri në janar 2015 janë arrestuar edhe rreth 80 persona të tjerë me akuza të ngjashme, përfshirë këtu edhe një numër të imamëve radikalë me ndikim. Si pasojë, që nga viti 2016 e deri më sot, asnjë luftëtar i huaj nga Kosova nuk ka shkuar në Siri dhe në Irak.

Së fundi, autorët pohojnë gabimisht që në vitet e fundit autoritetet kosovare kanë ndërmarrë masa diskriminuese kundër komunitetit serb në Kosovë, por nuk ka as edhe një dëshmi të vetme që mund të gjendet për ta dëshmuar një pohim të tillë.

¹² Qendra për të Drejtën Humanitare: 31,600 dokumente pa dyshim konfirmojnë vdekjet dhe zhdukjet e 13,535 individëve gjatë luftës në Kosovë, Beograd, 6 janar 2015, http://www.hlc-rdc.org/?page_id=14390&lang=de. Baza e shënimeve për Librin e Kujtesës së Kosovës është në dispozicion online në www.kosovomemorybook.org

¹³ Për hollësi të mëtejme shih: An Overview of the War Crimes Trials in Kosovo: 1999 – 2018 [Pasqyrë e Krimeve të Luftës në Kosovë: 1999 – 2018], Qendra për të Drejtën Humanitare, tetor 2018, <http://www.hlc-kosovo.org/wp-content/uploads/2018/10/HLC-Kosovo-An-overview-of-war-crime-trials-in-Kosovo-1999-2018.pdf>

¹⁴ Blakaj: Në Kosovë për krime luftime janë dënuar gjashtë serbë, në Serbi për krime të kryera në Kosovë janë dënuar 15 serbë [Bekim Blakaj, (Director of the Kosovo Office of the Fund for Humanitarian Law): In Kosovo for war crimes are convicted six serbs, in Serbia for war crimes committed in Kosovo were convicted 15 Serbs], Telegraf, 15 mars 2019, <https://telegrafi.com/blakaj-ne-kosove-per-krime-lufte-jane-denuar-gjashte-serbe-ne-serbi-per-krime-te-kryera-ne-kosove-jane-denuar-15-serbe-video/>

Lajmërim i Dezinformatës: 2

Titulli: Too little, too late: Kosovo President Thaçi's indictment for war crimes 20 years on isn't justice for Serbia – it's a travesty [Tepër pak, tepër vonë: Padia kundër Presidentit Thaçi 20 vite më pas nuk është drejtësi për Serbinë – ajo është farsë], **Russia Today**, **28 qershor 2020**.¹⁵

Autori i këtij artikulli është John Laughland, një studiues britanik kontravers, i cili, deri në kohët e fundit, ishte Drejtor i Studimeve në Institutin për Demokraci dhe Bashkëpunim në Paris, që udhëhiqet nga Natalia Narochinskaya, një historiane ruse që më parë ishte anëtare e Dumas. Laughland ndër të tjera e ka botuar librin *Travesty: The Trial of Slobodan Milošević and the Corruption of International Justice* [Farsa: Gjykimi i Slobodan Millosheviqit dhe Korrupsioni i Drejtësisë Ndërkombëtare] (Pluto Press, London, 2007), në të cilin argumentonte që “drejtësia ndërkombëtare është një ëndërr e pamundshme dhe që shfaqjet e gjykimeve të tilla nuk janë asgjë më tepër se një ushtrim propagandues i përgatitur për ta tërhequr vëmendjen nga krimet e luftës të kryera nga shtetet perëndimore.”¹⁶

Ndër të tjera, në këtë artikull Laughland argumenton që: “Si një person që e kundërshtoi fuqishëm dhe zëshëm sulmin e NATO-s kundër Jugosllavisë në vitin 1999, i cili u përligj në emër të ‘të drejtave njerëzore,’ dhe si gazetari i fundit perëndimor që u takua dhe e intervistoi ish-Presidentin e Jugosllavisë, Slobodan Millosheviq, në qelinë e tij në Hagë, para se ta shkruaja një libër për gjykimin e tij pasi që ai vdiq në arrest, mund të pritet që do ta mirëpres këtë shpallje [publikimin e padisë kundër Hashim Thaçit];” “Gjatë dhe pas bombardimit të Jugosllavisë, e tërhoqa vëmendjen në propagandën luftarake të NATO-s, e cila egërsisht i zmadhonte dhe i paraqiste ndryshe vrazhdësitë e kryera nga forcat serbe kundër shqiptarëve në Kosovë. Unë po ashtu e tërhoqa vëmendjen ndaj mizorive të kryera nga UÇK-ja, të cilat propaganda e NATO-s kurrë nuk i përmendte. Kështu, për shembull, në dhjetorin e vitit 1999 kam shkruar që UÇK-ja

¹⁵ Russia Today, <https://www.rt.com/op-ed/493063-thaci-indictment-kosovo-serbia/>

¹⁶ Pluto Books, Independent Radical Publishing, *Travesty: The Trial of Slobodan Milošević and the Corruption of International Justice* [Farsa: Gjykimi i Slobodan Millosheviqit dhe Korrupsioni i Drejtësisë Ndërkombëtare], (2007), <https://www.plutobooks.com/9781783715770/travesty/>

ishite “një forcë mizore e terroristëve që merreshin me droga, e cila madje edhe tash është duke e kryer spastrimin etnik, duke i sulmuar dhe vranë serbët, romët, çifutët, myslmanët dhe shqiptarët ‘jolojalë’, dhe që personalisht besoj që Thaçi është fajtor, dhe që Serbia ka qenë viktimë e një padrejtësie të tmerrshme.”

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Autori e injoron faktin e vdekjeve dhe zhdukjeve të 13,535 individëve gjatë luftës në Kosovë dhe menjëherë pas saj (1 janar 1998 – 31 dhjetor 1999). Ai po ashtu e injoron faktin tashmë të përmendur që 10,812 veta nga ky numër ishin shqiptarë, 2,197 ishin serbë, dhe 526 viktima ishin romë, boshnjakë, malazezë dhe jo-shqiptarë të tjerë,¹⁷ njësoj si dhe faktin që brenda disa javëve pas fillimit të intervenimit të NATO-s, forcat e armatosura serbe i vranë më tepër se 9,000, dhe i dëbuan në Shqipëri dhe Maqedoni rreth 860,000 shqiptarë të Kosovës.¹⁸ Këto vuajtje njerëzore ai i emërton si propagandë të NATO-s, duke e bërë të qartë në këtë mënyrë që për të, jetët e viktimave shqiptare dhe dimensionin humanitar të intervenimit të NATO-s, të cilat ishin pasoja të mizorive të Millosheviqit, si dhe përgjegjësia e Beogradit për këto vepra, nuk kanë rëndësi, duke e konsideruar Serbinë si viktimë të një padrejtësie të tmerrshme.

Ndërkohë që drejtësia për krimet e luftës në Kosovë zbatohet përmes tre mekanizmave ndërkombëtarë të drejtësisë, dhe atë UNMIK-ut, EULEX-it dhe Dhomave të Specializuara, pos gjykatave kombëtare, asnjëri nga udhëheqësit dhe anëtarët e UÇK-së nuk i është shmangur obligimeve të veta për të qenë përgjegjës para drejtësisë ndërkombëtare duke u arratisur, gjë kjo që nuk përkon me përshkrimin e Laughlandit për UÇK-në si një “forcë terroriste mizore e udhëhequr nga droga.” Nga ana tjetër, Serbia ka qenë duke i fshehur kriminelët famëkeq të

¹⁷ Qendra për të Drejtën Humanitare: 31,600 dokumente pa dyshim konfirmojnë vdekjet dhe zhdukjet e 13,535 individëve gjatë luftës në Kosovë, Beograd, 6 janar 2015, http://www.hlc-rdc.org/?page_id=14390&lang=de. Baza e shënimeve për Librin e Kujtesës së Kosovës është në dispozicion online në www.kosovomemorybook.org

¹⁸ Për një hetim më të thellë për pasojat e krizës së refugjatëve të Kosovës, shih, për shembull: Jim Whiteman, The Kosovo Refugee Crisis: NATO’s humanitarianism versus human rights [Kriza e refugjatëve të Kosovës: Humanitarizmi i NATO-s përballë të drejtave njerëzore], *The International Journal of Human Rights*, Vol. 4, Issue 3-4, Taylor & Francis, 2000.

luftës, Radovan Karaxhiq (2008),¹⁹ dhe Ratko Mladić (2011),²⁰ që kanë qenë përgjegjës për gjenocidin në Bosnje e Hercegovinë, dhe nuk është duke ndërmarrë hapa seriozë për t'i gjykuar ata që janë përgjegjës për krimet në Kosovë, pavarësisht nga fakti që të dhënat për strukturën komanduese të njësive policore dhe ushtarake që kanë vepruar në Kosovë gjatë luftës ekzistojnë – deri më tash vetëm 17 ushtarë dhe policë të rangut të ulët janë dënuar nga drejtësia serbe.²¹

Lajmërim i Dezinformatës 3

Headline: Yugoslavia bombings to remain disgraceful page for NATO states [Bombardimi i Jugosllavisë do të mbetet një faqe e turpshme për shtetet e NATO-s — shefi rus i sigurisë, TASS, 17 qershor 2020].²²

Në këtë artikull, TASS-i ka botuar pjesë të artikullit të Sekretarit të Këshillit Rus të Sigurisë, Nikolai Petrushev, të botuar në Rossiyskaya Gazeta. Sipas TASS-it, Petrushev ka pohuar që “Bombardimi barbar i Jugosllavisë ishte një faqe e veçantë e turpshme në historinë e të gjitha vendeve të NATO-s, dhe do të mbetet i tillë.”

Sipas TASS-it, “NATO-ja e nisi operacionin ajror Forca Aleate kundër Republikës Federale të Jugosllavisë lidhur me situatën në Kosovë më 24 mars 1999. Gjatë operacionit që zgjati 78 ditë, aeroplanët e vendeve të NATO-s i bënë rreth 38,000 fluturime. Si rezultat i bombardimeve të

¹⁹ Karadzic arrested in Serbia: worked as a doctor [Karaxhiqi arrestohet në Serbi: Punonte si mjek], Reuters, 22 korrik 2008, <https://www.reuters.com/article/us-warcrimes-karadzic/karadzic-arrested-in-serbia-worked-as-doctor-idUSL2196241820080722>

²⁰ Ratko Mladić arrested: Bosnia war crimes suspect held [Arrestohet Ratko Mlladiq: I dyshuari për krimet e luftës në Bosnje në mbajtje], BBC, 26 maj 2011, <https://www.bbc.com/news/world-europe-13561407w:~:text=Fugitive%20Bosnian%20Serb%20war%20crimes,16%20years%20on%20the%20run.&text=Serbian%20President%20Boris%20Tadic%20said,The%20Hague%20was%20under%20way>.

²¹ Blakaj: Në Kosovë për krime luftime janë dënuar gjashtë serbë, në Serbi për krime të kryera në Kosovë janë dënuar 15 serbë [Bekim Blakaj (Director of the Kosovo Office of the Fund for Humanitarian Law): In Kosovo for war crimes are convicted six serbs, in Serbia for war crimes committed in Kosovo were convicted 15 Serbs], Telegraf, 15 mars 2019, <https://telegrafi.com/blakaj-ne-kosove-per-krime-lufte-jane-denuar-gjashte-serbe-ne-serbi-per-krime-te-kryera-ne-kosove-jane-denuar-15-serbe-video/>

²² Yugoslavia bombings to remain disgraceful page for NATO states — Russian security chief, [Bombardimi i Jugosllavisë do të mbetet faqe e turpshme për shtetet e NATO-s – Shefi i sigurisë ruse] TASS 17 qershor 2020.

NATO-s, nga 3,500 deri në 4,000 njerëz u vranë, dhe rreth 10,000 të tjerë u plagosën. Dy të tretat e tyre ishin civilë, sipas të dhënave të Serbisë.”

Dekonstruktimi i Dezinformatws: Fakte dhe Shifra

Bazuar në dëshmitë në dispozicion, Raporti i Human Rights Watch “Civilian Deaths in the NATO Air Campaign” [“Vdekjet e civilëve ne fushatën ajrore të NATO-s”] ka përfunduar se si pasojë e bombardimeve të NATO-s kanë vdekur jo më pak se 488, dhe jo më shumë se 527 civilë jugosllavë. Raporti më tutje qartëson se midis 278 dhe 317 të të vdekurve ishin në Kosovë, dhe se 201 civilë ishin vrarë në Serbi, dhe 8 në Mal të Zi.²³ Nga ana tjetër, të dhënat e detajuara të grumbulluara bazuar në 31,600 dokumente, të paraqitura në botimin “Libri i Kujtesës i Kosovës” (2 shkurt 2015), që është përgatitur nga Qendra për të Drejtën Humanitare me seli në Beograd, konfirmojnë që sulmet e NATO-s e kanë vrarë një total prej 754 njerëzish: 454 civilë dhe 300 pjesëtarë të forcave të armatosura. 207 civilë ishin të etnisë serbe dhe malazeze, 219 ishin shqiptarë, 14 ishin romë, dhe 14 ishin të kombësive të tjera. Në këtë mënyrë, shifrat për viktimat njerëzore si pasojë e fushatës ajrore të NATO-s të dhëna nga TASS-i janë një dezinformatë e pastër që synon t’ia shkatërrojë themelet rolit të Aleancës në përfundimin e vuajtjeve njerëzore në Kosovë dhe sigurimit të paqes dhe stabilitetit për Ballkanin e trazuar gjatë viteve 1990.

Lajmërim i Dezinformatës 4

Titulli: Албански премијер дојурио у Приштину да заштити НАТО играче из деведесетих [Kryeministri shqiptar vrapoi për në Prishtinë për t’i mbrojtur lojtarët e NATO-s nga vitet nëntëdhjetë], **Sputnik Serbia, 30 qershor 2020.**²⁴

²³ “Civilian Deaths in the NATO Air Campaign” [“Vdekjet e civilëve në fushatën ajrore të NATO-s”], Human Rights Watch Report, Vëllimi 12, Numri 1 (D), 2000, <https://www.hrw.org/reports/2000/nato/>

²⁴ Албански премијер дојурио у Приштину да заштити НАТО играче из деведесетих [Kryeministri shqiptar vrapoi për në Prishtinë për t’i mbrojtur lojtarët e NATO-s nga vitet nëntëdhjetë], Sputnik Serbia, 30 qershor 2020, <https://rs.sputniknews.com/analize/202006301122902686-albanski-premier-dojurio-u-pristinu-da-zastiti-nato-igrace-iz-devedesetih/>

Artikulli është një intervistë me avokatin Goran Petronijević, që pohon që Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, e dha një fjalim të zjarrtë para Kuvendit të Kosovës në përkrahje të ish udhëheqësve të të ashtuquajturës Ushtri Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli, pas shpalljes së propozimit për paditjen e këtyre dyve për krime të luftës. Me fjalë të tjera, Rama, në mënyrë të tërthortë, qëndroi për mbrojtjen e NATO-s, meqë Aleanca veproi bashkarisht me UÇK-në. NATO dhe UÇK ishin partnerë gjatë viteve 1990, dhe është e qartë që çdo padi do të sjellë në dyshim veprimet e NATO-s. Për më tepër, Petronijević ka pohuar që ai është i bindur që ata që e kanë sunduar SHBA-në në atë kohë i kanë ndihmuar UÇK-së dhe kanë qenë iniciatorët kryesorë të fjalëve të Ramës.

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Para së gjithash, Kryeministri Shqiptar Rama nuk e ka dhënë asnjë fjalim në Kuvendin e Kosovës lidhur me këtë çështje. Gjatë vizitës së tij në Kosovë, ai u takua me udhëheqësit e institucioneve të Kosovës (Presidentin, Kryesuesin e Kuvendit) dhe me Kadri Veselin, Albin Kurtin dhe Fatmir Limajn, në cilësitë e tyre si udhëheqës të partive politike të Kosovës. Së dyti, pohimi që Rama është duke e mbrojtur NATO-n nga Dhomat e Specializuara, dhe që çfarëdo padie do të sjellë në dyshim veprimet e Aleancës, është një manipulim i pakuptimtë, duke pasur parasysh që SHBA-të dhe BE-ja kanë qenë përkrahësit kryesorë të krijimit të Dhomave të Specializuara, dhe që Gjyqtari amerikan, John Clint Williamson, është emëruar si Prokurori Udhëheqës i BE-së i Task Forcës Speciale Hetuese për hetimin e pretendimeve për krimet e luftës të kryera nga ish-UÇK-ja, si reagim ndaj Raportit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, të paraqitur nga Senatori Dick Marty.²⁵ Bazuar në rezultatet e këtij hetimi të paraqitura më 29 korrik 2014,²⁶ në korrik të vitit 2015 janë krijuar Dhomat e Specializuara.²⁷

²⁵ EU External Action, Deklaratë për shtyp, John Clint Williamson appointed as Lead Prosecutor for the Special Investigative Task Force [John Clint Williamson emërohet si Prokuror Udhëheqës për Task Forcën Speciale Hetuese], 29 gusht 2011.

²⁶ [Special Investigative Task Force, Deklaratë për shtyp, 29 korrik 2014, http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2014/07/Press_release_EN.pdf](http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2014/07/Press_release_EN.pdf)

²⁷ Law on Specialist Chambers and Specialist Prosecutor's Office [Ligji për Dhomat e Specializuara dhe për Zyren e Prokurorit të Specializuar], Gazeta Zyrtare e Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11036>

Lajmërim i Dezinformatës 5

Titulli: Једини папир који чува Косово у Србији све док га Београд поштује [Е vetmja letër që Kosovën e ruan në Serbi, përderisa Beogradi ta respektojë], **Sputnik Serbia, 11 qershor 2020.**²⁸

Ky artikull është një intervistë me profesorin e të Drejtës Kushtetuese, Vladan Kustević, që ndër të tjera pohon që përderisa të ekzistojë Rezoluta e KS KB 1244, kjo do ta parandalojë Kosovën nga shndërrimi në një shtet të njohur ndërkombëtarisht, dhe që sipas këtij dokumenti, Kosova është një protektorat, që është një dispozitë njësoj e rëndësishme për ne [për Serbinë], e cila e ka një rëndësi të njëjtë me dispozitën që kjo është pjesë përbërëse e Serbisë.

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Para së gjithash, dhe mbi të gjithat, Kustević pohon gabimisht që Rezoluta e KS KB 1244 (1999) është një pengesë për njohjen ndërkombëtare të Kosovës, duke e shpërfilur Opinionin Këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Pajtueshmërinë me të Drejtën Ndërkombëtare të Shpalljes së Njëanshme të Pavarësisë në Lidhje me Kosovën, të 22 korrikut 2010. Ky Opinion Këshillues pohon qartë që Shpallja e Pavarësisë së Kosovës nuk e ka shkelur të Drejtën Ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe Rezolutën e KS KB 1244 (1999),²⁹ dhe, rrjedhimisht, Kosova mund të njihet ndërkombëtarisht, pavarësisht nga fakti që Rezoluta 1244 është ende në fuqi. Pos kësaj, pavarësia e Kosovës mund të bashkekzistojë me një protektorat formal dhe jo-ekzekutiv të Kombeve të Bashkuara që e ka bartur autoritetin e vet ekzekutiv te institucionet e Kosovës dhe Misioni i Sundimit të Ligjit i BE-së në Kosovë, dhe i cili tash e ka një cilësi tejet të kufizuar mbikëqyrëse.

²⁸ Једини папир који чува Косово у Србији све док га Београд поштује [Е vetmja letër që Kosovën e ruan në Serbi, përderisa Beogradi ta respektojë], Sputnik Serbia, 11 qershor 2020,

<https://rs.sputniknews.com/analize/202006111122753156-jedini-papir-cuva-kosovo-srbija-beograd-postuje/>

²⁹ Opinioni Këshillues i GJND-së për Shpalljen e Njëanshme të Pavarësisë së Kosovës, 22 korrik 2010,

<https://www.icj-cij.org/files/case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf>